



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 40.1, "b" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 143 dhe 145 të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovet buxheti i Komunës së Vushtrrisë dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2011, konform Qarkores Buxhetore të MEF-it 2011/02, dt. 03.08.2010.

Neni 2.

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2010 është 10.458.438.00 €, prej të cilave për:

• Paga	5.416.468.00 €
• Mallra dhe shërbime.....	980.051.00 €
• Komunalit	233.822.00 €
• Subvencione.....	159.862.00 €
• Shpenzime kapitale.....	3.668.235.00 €
Gjithsejtë:.....	10.458.438.00 €

Neni 3.

Të hyrat vetanake të planifikuara..... 1.315.000.00 €

Neni 4.

Mjetet financiare të cekura si në nenin 2 dhe 3 të këtij vendimi do të sigurohen në pajtim me Qarkoren buxhetore të MEF-it 2011/02 në bazë të kufijve të dhënë, Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe dispozitat tjera ligjore dhe akte tjera që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe organet tjera kompetente.

Neni 6.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 12 pika "d" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 52 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore nr.14/80 dhe 42/86 si dhe nenit 31.2, "g" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09. 2010, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjopa Komunale

Neni 1

Me këtë vendim plotësohet rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale 01Nr.742/08, dt.30.12.2008.

Neni 2

Neni 8 i rregullores së cekur, përkatësisht në fund të nenit 8 shtohet paragraf i ri si vijon:

Pagesat për tarifën e përcaktuara në këtë nen mund të bëhen në maksimumi në tri këste :

- Kësti i parë para marrjes së lejes ndërtimore,
- Kësti i dytë pasi të kryhen 50% e punëve ndërtimore të parapara me leje ndërtimore (kateve),
- Kësti i tretë pas mbulimit të objektit gjegjësisht pas kryerjeve të punëve të vrazhda ndërtimore.

Neni 3.

Në rast të mos pagesës së tarifave në mënyrën e përcaktuar si në nenin paraprak të këtij vendimi, obligohet inspekcioni i ndërtimit që të ndërmerr veprime të nevojshme ligjore për ndërprerje të përkohshme të punëve dhe ndalimin e vazhdimin të punimeve gjerë në ofrimin e dëshmisë për pagesën.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit si dhe Drejtoria për Inspektion në Vushtrri.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhje të Kuvendit të Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 12 ,17 dhe 24 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, “c” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, merr këtë:

V E N D I M

Për lejim të mjeteve për renovim të ish objektit të TMK-së

Neni 1

Nga buxheti i komunës, lejohen mjete financiare në shumë prej 14.416.50 € për renovim të objektit të ish TMK-së, Rr. “Skënderbeu” në Vushtrri, për vendosje të Arkivit Historik të Komunës.

Neni 2

Mjetet e cekura si nën nenin paraprak të këtij vendimi do të sigurohen nga mjetet e lira të mbetura nga projektet e këtij viti dhe do të ridestinohen për projektin në fjalë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtrri.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 12 ,17 dhe 24 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, “c” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, merr këtë:

V E N D I M

Për ndarje të mjeteve buxhetore për renovim të objektit – shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit në Vushtrri

Neni 1.

Nga buxheti i komunës lejohen mjete financiare në shumë prej 5.000.00 € për vitin 2010, për bashkëfinancim të projektit “renovimi i objektit – shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit në Vushtrri”.

Neni 2.

Projekti i cekur si në nenin paraprak të këtij vendimi do të realizohet me bashkëfinancim nga donatorë, në dy faza:

- Faza e parë do të filloj së realizuari në këtë vit (2010), ndërsa
- Fa e dytë në vitin 2011.

Neni 3.

Mjetet financiare për vitin 2011 për këtë projekt do të aprovohen me buxhetin e komunës të vitit 2011.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtrri.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 12 ,17 dhe 24 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "c" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, merr këtë:

V E N D I M

Për ndarje të mjeteve buxhetore për rindërtim të Kullës ë Azem Bejtës në Galicë

Neni 1.

Nga buxheti i komunës lejohen mjete financiare në shumë prej 5.000.00 € për vitin 2010, për bashkëfinancim të projektit "rindërtimi i kullës së heroit tonë kombëtar Azem Bejta, në fsh. Galicë të Komunës së Vushtrrisë".

Neni 2.

Projekti i cekur si në nenin paraprak të këtij vendimi do të realizohet me bashkëfinancim nga donatorë, në dy faza:

- Faza e parë do të filloj së realizuari në këtë vit (2010), ndërsa
- Fa e dytë në vitin 2011.

Neni 3.

Mjetet financiare për vitin 2011 për këtë projekt do të aprovohen me buxhetin e komunës të vitit 2011.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtri.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Bazuar në nenin 9 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës dt. 21.09.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, merr këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës dt. 21.09.2010 për fillimin e procedurës për ndryshimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Komisioni i veçantë i formuar me vendim të Kuvendit të Komunës ngarkohet që të hartoj dhe procedoj ndryshimet e statutit brenda afatit të caktuar ligjorë, konform me rregullativen ligjore në fuqi.

Neni 3.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 12 ,17 dhe 24 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, “c” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

Neni 1.

Formohet komisioni për hartim të ndryshimeve të Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Në përbërje të komisionit caktohen;

- Ferit Idrizi, kryesues i komisionit
- Muharrem Shabani, anëtar
- Veli Karaça, anëtar
- Idriz Muzaqi, anëtar
- Haki Maloku, anëtar

Neni 3.

Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake ka për detyrë që të hartoj dhe procedoj ndryshimet e statutit të komunës brenda afatit të caktuar ligjorë, konform rregullativës ligjore në fuqi,.

Neni 4.

Për punën e tij komisioni në fjalë do të kompensohet. Kryetari i Komunës do të vendos me vendim të veçantë lidhur me lartësinë e kompensimit për secilin anëtar të komisionit.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nën "c" të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës ndërtimore pronë e Komunës

Neni 1.

Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës-PTK Sh.A nga Prishtina i lejohej për shfrytëzim toka ndërtimore, në sipërfaqe prej 0.01.00ha (100m²), e cila është pjesë e parcelës kadastrale P-70202029-00506-0, Komuna Kadastrale Svaraçak, evidentuar në fletën poseduese nr.70, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Patundshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim për vendosjen e objektit të tipit montazh (të ashtuquajtura "Butik Posta") në afat prej 1 viti me mundësi vazhdimi. Kompensimi për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në pronësi të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet konform Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008 (neni 17 i kësaj rregulloreje).

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të palujtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh në organin kompetent. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse për këtë ekziston interesi i Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Vushtrri.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Bazuar në nenin 12.2 “d”, 24 dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenin 31.2 “c” të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të MASHT dhe MEF, të datës 23.04.2010, me propozim të Drejtorisë komunale për Arsim, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, merr këtë:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetanake për v. 2010 dhe 2011

Neni 1.

Me këtë vendim rriten të hyrat vetanake të komunës për SHMT “Lutfi Musiqi” dhe SMP “Bahri Haxha” në Vushtrri, për vitin 2010 në shumë prej 25.750.00 € dhe për vitin 2011 në shumë prej 28.250.00 €.

Neni 2.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa në Vushtrri.

Neni 3.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nën "c" të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M
Për plotësimin e vendimit

Neni 1.

Me këtë vendim plotësohet vendimi i kuvendit të komunës së Vushtrrisë 01Nr.127/10 dt. 27/05/2010.

Neni 2.

Në nenin 1 të vendimit të njejt sipërfaqes prej 02.00.00 ha, në ngastrën e njejtë kadastrale, i shtohet ngjitas sipërfaqja prej 01.00.00 ha. Kjo sipërfaqe gjithashtu ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim personave të interesuar për zhvillim të veprimtarive shërbyese, prodhuese, tregtare.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Vushtrri.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 6 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, nenit 17 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "o" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë , Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Bordit Këshillues për dhënien e këshillave për hartimin e planeve rregulluese të qytetit të Vushtrrisë

Neni 1.

Me qëllim të ofrimit të këshillave dhe sugjerimeve gjatë procesit të hartimit të planeve rregulluese për qytetin e Vushtrrisë dhe Komunën e Vushtrrisë, emërohet Bordi Këshillues në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, Nënkryetare e Komunës
2. Ferit Idrizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
3. Idriz Ismajli, Drejtor për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit
4. Nezir Klinaku, Drejtor për Kadastër dhe Gjeodezi
5. Dibran Perquku, Drejtor për Shërbime Publike
6. Nasuf Aliu, Drejtor për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim
7. Qerim Selimi, Drejtor për Arsimit
8. Safet Idrizi, Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
9. Bajram Beqiri, Drejtor për Inspeksion
10. Naim Hyseni, Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim
11. Qamil Sahiti, Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport
12. Avdullah Halimi , anëtar i KK-së
13. Shpetim Zhegrova, anëtar i KK-së
14. Naile Osman, anëtar i KK-së
15. Ergin Sunguri, anëtar i KK-së
16. Sabit Kadriu, anëtar i KK-së
17. Makfirete Ademi, anëtare e KK-së

18. Sabri Ferati, anëtar i KK-së

19. Remzije Isufi, anëtare e KK-së

Neni 2.

Detyrë e Bordit këshillues është që të japë këshilla, mendime dhe sugjerime gjatë të gjitha fazave të hartimit të planeve rregulluese për qytetin e Vushtrrisë si dhe për të njëjtin të japë pëlqimin për prezantim publik.

Neni 3.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 17 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 31 pika të Statutit të Komunës së Vushtrrisë , Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 30.09.2010 mori këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË KOMUNËS NË
VUSHTRRI

Neni 1.

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Komunës në Vushtri në ngastrën kadastrale nr.667, në vendin e quajtur "Qytet" me kulturë jo pjellore, në sipërfaqe prej 0,31.24 ha, fleta poseduese nr.45, Zona Kadastrale Vushtri pronë e Komunës së Vushtrrisë. (lokacioni i tregut të tanishëm në qendër të qytetit).

Neni 2.

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Vushtri.

Neni 3.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen”c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 31.2 nen “n” të Statutit të Komunës dhe Vendimit të KK-së 01 Nr.185/10 të datës 29.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) z.Haki Bekteshi nga Stanoci i Poshtëm, pjesa e parcelës Kadastrale 8-412, me fletë poseduese nr.198(12/287), në sipërfaqe prej 25 ari, Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim konform vendimit të K.K-ës, 01.Nr.512/09, dt.30.07.2009, në afat prej 20 vite me mundësi vazhdimi të këtij afati për ndërtimin e një objekti në lëmin e auto-mekanikës me veprimtari prodhuese-shërbyese.

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm (mbi qiranë).

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë, dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmëris nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj patundshmërie për të cilin i është dhënë në shfrytëzim, pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cilado të bëj skicimin në elaboratin

kadastral të sipërfaqes së tokës që i ipet në shfrytëzim, ndarjen fizike dhe përcaktimin e pikave kufizuese në teren.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit si dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 31.2 nen "n" të Statutit të Komunës dhe Vendimit 01 Nr.185/10 të datës 29.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënjen në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, z. Isa Hajrizi nga Vushtrria, pjesa e parcelës Kadastrale 8-412 ,me fletë poseduese 198(12/287), në sipërfaqe prej 50 ari, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim konform vendimit të K.K-s, 01.Nr.512/09, dt.30.07.2009, në afat prej 20 vite me mundësi vazhdimi të këtij afati, për shfrytëzimin e Depos dhe ndërtimin e një aneksi për zgjerim të veprimtarisë së prodhimit rrobave dhe uniformave .

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me kontratën mbi qiranë.

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë, dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmërisë nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj patundshmërie për të cilin i është dhënë në shfrytëzim, pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cilado të bëj skicimin në elaboratin

kadastral të sipërfaqes së tokës që i ipet në shfrytëzim, ndarjen fizike dhe përcaktimin e pikave kufizuese në teren.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen" c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 31.2 nen "n" të Statutit të Komunës , dhe Vendimit 01 Nr.185/10 të datës 29.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, z.Jeton Klinaku nga Vushtrria, pjesa e parcelës Kadastrale 8-412, me fletë poseduese 198(12/287), në sipërfaqe prej 50 ari, Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim konform vendimit të K.K-s, 01.Nr.512/09, dt.30.07.2009, në afat prej 20 vite, me mundësi vazhdimi të këtij afati, për ndërtimin e fabrikës së mobiljeve me trendin Italian.

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me kontratën mbi qiranë.

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmërisë nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj prone e cila i është dhënë në shfrytëzim pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cilado të bëj skicimin në elaboratin

kadastral të sipërfaqes së tokës që i ipet në shfrytëzim, ndarjen fizike dhe përcaktimin e pikave kufizuese në teren.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit si dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen" c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 31.2 nen "n" të Statutit të Komunës , dhe Vendimit 01 Nr.185/10 të datës 29.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, z.Kreshnik Basholli nga Vushtrria, pjesa e parcelës Kadastrale 8-412, me fletë poseduese 198(12/287), në sipërfaqe prej 70 ari, Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim konform vendimit të K.K-s, 01.Nr.512/09, dt.30.07.2009, në afat prej 20 vite me mundësi vazhdimi të këtij afati për ndërtimin e fabrikës për prodhim të ëmbëlsirave.

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me kontratën mbi qiranë.

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmërisë nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj prone e cila i është dhënë në shfrytëzim pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cilado të bëj skicimin në elaboratin kadastral të sipërfaqes së tokës që i ipet në shfrytëzim, ndarjen fizike dhe përcaktimin e pikave kufizuese në teren.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen" c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 31.2 nen "n" të Statutit të Komunës , dhe Vendimit 01 Nr.185/10 të datës 29.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, z.Musa Caka nga Stanovci i Epërm, pjesa e parcelës Kadastrale 434-7, në sipërfaqe prej 80 ari, fleta poseduese nr.P-70202011, Zona Kadastrale Lum Madh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim konform vendimit të K.K-s, 01.Nr.512/09, dt.30.07.2009, në afat prej 20 vite me mundësi vazhdimi të këtij afati për ndërtimin e objektit në lëmin e auto-mekanikës dhe prodhimin e koncentrateve bujqësore si veprimtari prodhuese-shërbyese..

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me kontratën mbi qiranë.

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmërisë nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj prone e cila i është dhënë në shfrytëzim pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cilado të bëj skicimin në elaboratin kadastral të sipërfaqes së tokës që i ipet në shfrytëzim, ndarjen fizike dhe përcaktimin e pikave kufizuese në teren.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen" c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 31.2 nen "n" të Statutit të Komunës , dhe Vendimit 01 Nr.185/10 të datës 29.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, (me qira) z. Shyqri Selmani nga Prugovci i Prishtinës pronar i ndërmarrjes "BARILEVA" sh.p.k., pjesa e parcelës Kadastrale 8-412, me fletë poseduese nr.198(12/287), në sipërfaqe prej 1 hektarë, Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim konform vendimit të K.K-s, 01.Nr.512/09, dt.30.07.2009, dhe në afat prej 20 vite me mundësi vazhdimi të këtij afati për ndërtimin e fabrikës të miellit dhe produkteve nga mielli si dhe përpunimin e këtyre produkteve .

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me kontratën mbi qiranë.

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmërisë nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj prone e cila i është dhënë në shfrytëzim pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cilado të bëj skicimin në elaboratin kadastral të sipërfaqes së tokës që i ipet në shfrytëzim, ndarjen fizike dhe përcaktimin e pikave kufizuese në teren.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit si dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI



Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nen”c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 31.2 nen “n” të Statutit të Komunës , si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorit të Bankës Kombëtare Tregtare dega në Prishtinë, 02-7-4427, dt16.10.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2010, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 1.

Me këtë vendim, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira), Bankës kombëtare Tregtare dega në Kosovë, parcela Kadastrale P-70202016-00127-0, vendi i quajtur VAROSH/MARSHALA TITA, (Rruga “Dëshmorët e Kombit”), në sipërfaqe prej 344 m², (trolli dhe kati përdhes i objektit i cili gjendet në këtë parcelë), fleta poseduese UL-70202016-03960, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Prona e paluajtshme e cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim në shumë prej 1.300.00 € (njëmijetreqind euro) në muaj, në afat prej 5 viteve me mundësi të vazhdimi të këtij afati për hapjen e filiales së Bankës Tregtare Kombëtare, dega në Kosovë, me kusht të renovimit të brendshëm të katit përdhes dhe pjesës së jashtme të objektit në tërësi i cili gjendet në kuadër të kësaj parcele kadastrale. Pagesa e kësaj të parë mujor (qirasë mujore) duhet të përcaktohet me kontratë mbi qiranë dhe duhet të filloj nga data 01.11.2010.

Neni 3.

Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmerisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh me organin kompetent të komunës. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse qiramarrësi nuk i përmbahet obligimeve të parapara me këtë vendim dhe kontratën mbi qiranë.

Neni 4.

Prona e cila i ipet në shfrytëzim mbetet në pronësi të komunës së Vushtrrisë dhe se marrësi në shfrytëzim i patundshmëris nuk mund të ia ndërroi destinimin kësaj prone si dhe nuk mund ta jap me qira apo të ia tjetërsoj personit të tretë pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Vushtri.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi